



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2127/1 prot.

Tiranë, më 22.10.2024

VENDIM

Nr. 20, datë 22.10.2024

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2127 prot., datë 01.10.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Drejtësisë.

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 02.00.2024, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. Listën e nxjerrë nga sistemi elektronik i chekimit të hyrje-daljeve për periudhën gusht 2023 – gusht 2024, për zyrtarin z. Edvin Simo.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Autoriteti Publik/Ministria e Drejtësisë, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ankuesin se: “...informacioni i kërkuar nga ju, janë të dhënat e hyrje-daljeve të gjeneruara nga sistemi elektronik, të cilat nuk përbëjnë “informacion publik” referuar pikës 2, të nenit 2, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 606, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar...”, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e

informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*”, ka verifikuar legjislacionin përkatës aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Nga verifikimi paraprak, pika 2 e nenit 2 të LDI, parashikon se: “*Informacion publik*” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.”

Pika 3 e nenit 3 të LDI, parashikon se: “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.*”

Nga analiza e neneve të sipërcituara, informacioni/dokumentacioni i cili duhet kërkuar nëpërmjet ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, duhet të kufizohet në informacion/dokumentacion, i cili reflekton punën e administratës publike, dhe që duhet të ketë një interes publik madhor.

Informacioni i kërkuar, chekimi i hyrje-daljeve, nuk konsiderohet informacion publik, pasi nuk reflekton punën e kryer nga administrata publike, por do të konsiderohet si një nga kriteret për të kryer vlerësimin e punës së punonjësit të administratës, dhe si i tillë është jashtë tagrave ligjore për t’u trajtuar sipas LDI.

Neni 17 i ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, parashikon se: “*...Dosja dhe regjistri i personelit, 1. Çdo institucion shtetëror, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore krijojnë dhe administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit të institucionit (dosja individuale). Dosja individuale përmban të dhënat profesionale për çdo të punësuar dhe nëpunës civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, lidhur me marrëdhëniet e punës. 2. Departamenti i Administratës Publike krijojnë dhe administrojnë Regjistrin Qendror të Personelit, që është një bazë unike shtetërore të dhënash, që përfshin të dhënat profesionale dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo të punësuarit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. 3. Çdo institucion i administratës shtetërore, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore është i detyruar të japë të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. 4. Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe të përdorimit të të dhënave...*”

Në zbatim të pikës 4 të nenit të sipërcituar, është nxjerrë nga ana e Këshillit të Ministrave, vendimi nr. 833, datë 28.10.2020, “Për Rregullat e Hollësishme Për Përmbajtjen, Procedurën Dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrin Qendror të Personelit”, i cili në kapitullin e II-të përcakton qartazi se: “*1. Dosja e personelit është*

individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. 2. Dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me këtë dosje janë: a) i punësuar, të cilit i përket dosja; b) eprori direkt; c) nëpunësit e njësisë së burimeve njerëzore që përgjigjen për mbajtjen dhe sistemimin e tyre; ç) titullari i institucionit; d) sekretari i Përgjithshëm; dh) Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil; e) Departamenti i Administratës Publike; si dhe ë) institucione të tjera të ngarkuara nga ligji. 3. Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar. 4. Çdo i punësuar në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore është i detyruar t'u përgjigjet menjëherë kërkesave të njësisë së burimeve njerëzore për të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, si dhe të njoftojë menjëherë për ndryshimin e tyre, duke paraqitur edhe dokumentin përkatës që vërteton këto ndryshime. 5. I punësuar mban përgjegjësi ligjore individuale për vërtetësinë e të dhënave që jep për plotësimin e dosjes së personelit. 6. Me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, dosja personale i kthehet të punësuarit dhe institucioni mban një kopje të saj.”

Për sa më sipër, në analizë të legjislacionit të referuar, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni/informacioni i kërkuar nga ankuesi, do të kufizohet, pasi edhe pse subjektet për të cilët janë kërkuar vlerësimet e punës, janë funksionar publik, parashikimi në shkronjën b) të pikës 4 të nenit 4, të ligjit 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”, në rastin konkret, do të aplikohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me pikën 1, gjermës “a” të nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, që garanton të drejtën për një jetë private.

Dokumentacioni/informacioni i kërkuar nga ankuesi, do të trajtohet në përputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, “Për Rregullat e Hollësishme Për Përmbajtjen, Procedurën Dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”, bazuar dhe në parimin e mjaftueshmërisë të të Dhënave, duke mbajtur në konsideratë garantimin e të drejtës kushtetuese për një jetë private.

Në këtë kuptim, përhapja e këtij informacioni do të kufizohet dhe nuk mund të vihen në dispozicion të askujt pa pëlqimin paraprak të tij. Aksesimi në dokumentacionin të dosjes personale të subjektit do të jetë i limituar, në zbatim të ligjeve të sipërcituara, vetëm në dhënien e emrit, mbiemrit dhe pozicionit të punës në administratën publike.

Këndvështrimi i mësipërm, gjen mbështetje dhe në udhëzimet e nxjerra nga European Data Protection Supervisor, i cili në Udhëzimin e Vlerësimit të datës 11.07.2015, i aksesueshëm në linkun https://www.edps.europa.eu/sites/default/files/publication/11-07-15_evaluation_guidelines_en.pdf, konsideron vlerësimin e punës si përpunim të dhënash personale në tërësinë e aktit pasi: “...vlerësimi i performancës së stafit, kryesisht përbehet

nga gjykime subjektive të eprorëve...”, rrjedhimisht European Data Protection Supervisor, ka këshilluar që në formularin e vlerësimit të performancës së stafit të vendoset një klauzolë për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, rrjedhimisht duke mos u përhapur tek të tretët pa u marrë pëlqimi paraprak i punonjësit si dhe është trajtuar në çështjen: Federación de Servicios de Comisiones Obreras (CCOO) v Deutsche Bank SAE, (arsyetimi dhe vendimi janë të aksesueshëm në linkun: <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=3B0A0FC2D7580D0E3811E3A8F0443D76?text=&docid=214043&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=2236952>), të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Në trajtimin e çështjes të mësipërme, Gjykata Europiane e Drejtësisë, e konsideron check-in e kryer nga punonjësit, si një mjet opsional, të rregulluar nga Kodi i Punës, për zbatimin e detyrimeve kontraktuale të punonjësit, duke analizuar në tërësi kohën e punës së kryer, marrjen e shpërblimit për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, etj.,

Për sa më sipër, lista ditore, mujore apo vjetore e check-in-eve, do të lidhet ngushtësisht me marrëdhëniet kontraktuale midis punëmarrës dhe punëdhënes dhe si i tillë do të trajtohet ngushtësisht si një element i të dhënave personale të mbrojtura nga pika 1 e gërmës “a” të nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar dhe ligji 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Tërësia e legjislacionit, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga European Data Protection Supervisor, është në linjën se përpunimi i të dhënave personale, si dhe vlerësimet, të cilat do të konsiderohen gjykime subjektive, përbejnë të dhëna personale, dhe si të tilla nuk mund të përhapen pasi janë të dhëna të cilat janë mbledhur për një qëllim të caktuar dhe në asnjë mënyre nuk mund të përhapen apo të publikohen pa u marrë pëlqimi i palëve.

Theksojmë se objekti i LDI është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit administrativ, të cilat nuk bëjnë pjesë në rastet kufizuese të nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, për sa më sipër parashtruar, rezulton se dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi, nuk është dokumentacion me karakter publik në kuptim të ligjit, pasi bën pjesë në rastet kufizuese të parashikuara nga neni i sipërcituar.

Për rrjedhojë, për gjithë shkaqet e lartpërmendura, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 2127 prot., datë 01.10.2024, të z. _____, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Drejtësisë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi pala ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 22.10.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi